



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI



100 Vjet Pavarësi

Nr. 5278 Prot.

Tirane, më 13/12/2012

URDHËR

Nr. 345, datë 13/12/2012

MBI MIRATIMIN E LABORATOREVE VETERINARË SHTETERORË NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 120 pika 6 të ligjit nr.10465 datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse për Bujqësinë,

URDHËROJ

1. Miratimin e laboratorëve veterinarë shtetëror si më poshtë:

- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Berat
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Dibër
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Durrës
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Elbasan
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Fier
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Gjirokastrë
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Korçë
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Kukës
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Lezhë
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Shkodër
- Laborator veterinar diagnostik, Drejtoria Rajonale e AKU, Vlorë

2. Këta laboratorë do të kryejnë analiza bakteriale dhe parazitare për diagnozën e sëmundjeve në kafshë.

MINISTRI

GENC RULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRI



100 Vjet Pavarësi

Nr. 5279 Prot.

Tirane, më 13/12 2012

UDHËZIM

Nr. 14 datë 13.12 2012

**MBI KRITERET, QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË LABORATOR VETERINAR
I AUTORIZUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 121 pika 3 të ligjit nr.10465 datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar,

UDHËZOJ

1. Laboratorët veterinar privat dhe laboratorët veterinar shtetëror të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 119, dhe 120 të ligjit nr. 10465 datë 29.9.2011“Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” paraqesin kërkesën për autorizim për kryerjen e analizave laboratorike veterinare zyrtare, pranë Drejtorisë së Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Drejtoria e Shërbimit Veterinar i përcjell Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë kërkesat e paraqitura sipas pikës 1, për kryerjen e vlerësimit të këtyre laboratorëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim.
3. Kriteret të cilat duhet të plotësohen nga laboratorët e interesuar për t’u autorizuar sipas pikës 1 me lart, janë si vijon:
 - a) Laboratori të ketë në perberje të tij jo më pak se një mjek veterinar i cili të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë pune dhe të ketë kryer kualifikimin në fushën e analizës laboratorike në ISUV;

- b) Specialistët dhe teknikët e laboratorit të kenë kryer kualifikimin në fushën e analizës laboratorike në ISUV;
- c) Laboratori të ketë kaluar me sukses teste krahasuese ndërlaboratorike të organizuara nga ISUV, për provat ku kërkon të autorizohet, të paktën një herë në vit;
- d) Të zbatojë metodologji të njëjtë analitike me Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe të miratuar nga ky i fundit;
- e) Të demonstrojë zbatimin e praktikave të mira të punës në laborator, të pasqyruar në dokumentacion;
- f) Të garantojnë zbatimin e normave të biosigurisë për testet të cilat realizohen nga laboratorit dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës;
- g) Të jenë të akredituara në përputhje me standardet kombëtare;

4. Vlerësimi i laboratorëve për plotësimin e kriterëve të mësipërme bëhet nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në cilësinë e Qendrës Kombëtare të Referencës Laboratorike Veterinare.

5. Pas përfundimit të vlerësimit të bërë mbi plotësimin e kriterëve të mësipërme, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë i dërgon Drejtorisë së Shërbimit Veterinar përfundimet e arritura mbi plotësimin e kriterëve nga laboratorët të cilët kanë paraqitur kërkesën për autorizim.

6. Me propozimin e Drejtorisë së Shërbimit Veterinar, Ministri autorizon laboratorët veterinarë të cilët kanë plotësuar kriteret e mësipërme.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

GENËRALI